

Znj. _____, përshendetje.

Me anë të e.mail, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejten e Informimit”, i jeni drejtuar Bashkisë Shkodër, me kërkesen për informacion nëse pasuria me nr._____, Z.K._____, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër dhe aktet në pronësi të saj.

Përsa më sipër, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejten e Informimit”, neni 11/1, kërkesa për informacion duhet të jetë e nënshkruar nga personi i interesuar. Meqenë se, jeni përfaqësuese e personit kërkues, për çështjen civile e cila ndodhet në rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bashkangjitur kërkesës për informacion të firmosur, të keni prokuren si person përfaqësues si dhe certifikaten e pronësisë dhe hartën treguese.

Nëse pasuria ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër, për të cilën ju kërkoni dhe aktet në pronësi të saj, ju bëj me dije se me Vendim nr.84 të Këshillit Bashkiak, date 26.12.2017, tarifa për dhënie dokumentacioni njësuar me origjinalin (nëse e kërkoni të tillë) është 500 lekë.

Do të ishte në interes të personit të interesuar, që të paraqitej pranë Zyrës me Një Ndalesë në Bashkinë Shkodër, për të bërë kërkesen për informacion.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë

Gjergj Kurti

P/Z1N

dhe

Koordinator i së Drejtës për Informim

Bashkia Shkodër